



BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

TETOR 2024

BULETINI I ZYRËS SË KRYEPROKURORIT TË SHETIT

TETOR 2024

Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet e ZKPSH-së për muajin TETOR 2024

Diskutohet shtimi i kapaciteteve humane profesionale në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

Mitrovicë, 1 Tetor 2024 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, së bashku me Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, z. Nijazi Rexha, kanë zhvilluar takim me përfaqësuesit e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të kryesuar nga shefi i zyrës për sundim të ligjit, z. Antero Lopes, koordinatorja për projekte, znj. Jehona Dragaj, si dhe menaxheri i projektit për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe qasjes në drejtësi në UNDP, z. Ardian Latifaj.



Qëllimi i këtij takimi të përbashkët ishte diskutimi i mundësive për mbështetjen e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë përmes shtimit të kapaciteteve humane profesionale, respektivisht zyrtarëve ligjor dhe përkthyesve sipas nevojave të kësaj prokurorie.

Në këtë drejtim, U.D. Kryeprokurori Kelmendi ka falënderuar mysafirët për gatishmërinë e treguar për të mbështetur Prokurorinë Themelore në Mitrovicë në ngritjen e efikasitetit të punës në funksion të forcimit të sundimit të ligjit.

Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve vizitoi Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore Pejë

Gjakovë dhe Pejë, 04 tetor 2024 - Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve - Prokurori i Zyrës së

Kryeprokurorit të Shtetit z. Bahri Hyseni së bashku me zyrtarët e deleguar nga institucionet ligjzbatuese në këtë zyrë dhe përfaqësuesin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, vizituan sot Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Pejë.



Gjatë takimeve të mbajtura në këto prokurori, prokurori Hyseni i njoftoi të pranishmit për funksionalizimin e Zyrës për Rikthim të Aseteve, si dhe Procedurat Standarde të Veprimit, duke kërkuar bashkëpunim nga prokurorët e këtyre prokurorive me këtë zyrë, me qëllim të këshillimit dhe ndihmës për të gjithë prokurorët që kanë raste ku duhet të aplikohen procedurat për rikthimin e asetëve.



Gjatë këtyre takimeve është diskutuar dhe janë shkëmbyer mendime mbi përmirësimin e procedurave dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, ku në këtë drejtim ishte gjurmimi, ngrirja dhe sekuestrimi i asetëve të përfituara përmes veprave penale, si dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar për rritjen e efektivitetit në këtë proces, u konsiderua kyç për suksesin e këtyre përpjekjeve, duke ndihmuar në kthimin e asetëve të paligjshme dhe zbardhjen e rasteve të rëndësishme kriminale.



Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë z. Enis Gashi, zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, z. Ersan Qavolli së bashku me prokurorët e këtyre prokurorive, falënderuan pjesëmarrësit për vizitën e tyre duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me këto institucione për të arritur rezultate sa më të mira.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, priti në takim Ministrin e Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, Igor Filkov

Prishtinë, 8 tetor 2024 – Në kuadër të shkëmbimit të përvojave të sistemeve rajonale të drejtësisë, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, së bashku me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, Laura Pula dhe Agron Qalaj, priti në takim Ministrin e Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, Igor Filkov, së bashku me bashkëpunëtorët e tij.



Fillimisht, z. Kelmendi informoi z. Filkov për shtrirjen organizative dhe proceset aktuale të punës së Prokurorit të Shtetit, me theks të veçantë në

zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim fuqizimin e sistemit prokurorial, duke shprehur me këtë rast edhe gatishmërinë dhe përkushtimin e tij për të vazhduar më tej bashkëpunimin me institucionet e sistemit prokurorial dhe mekanizmat e tjerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. “Mirëpres vazhdimin e bashkëpunimit dypalësh me institucionet e drejtësisë, duke pasur parasysh përkrahjen dhe mbështetjen e plotë dhe të ndërsjellë ndërshtetërore në drejtim të garantimit të integritetit dhe profesionalizmit të sistemeve tona prokuroriale”, tha ndër të tjera z.Kelmendi.



U.D. Kryeprokurori i Shtetit në vijim të takimit zhvilloi një bashkëbisedim të gjerë me delegacionin e lartë të shtetit të Maqedonisë së Veriut, veçanërisht sa i përket interesimit të tyre për të pasur informacione të zgjeruara për funksionimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL) në sistemin prokurorial.

Nga ana tjetër, Ministri i Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, Igor Filkov, ka falënderuar z.Kelmendi për pritjen e bërë dhe mundësinë e shkëmbimit të përvojave për të pasur një pasqyrë më të qartë për ndërtimin e urave të bashkëpunimit për fuqizimin e sundimit të ligjit në të dyja vendet.

Gjithashtu, ky delegacion vizitoi edhe ambientet e Prokurorisë Speciale, ku është njohur nga afër me procesin e punës, zhvillimin dhe funksionimin e SMIL-it në këtë prokurori, i cili është një projekt madhor i shtrirë në tërë sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

Në përmbyllje të këtij takimi, bashkëbiseduesit janë pajtuar për krijimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm përgjatë proceseve të ardhshme në kuadër të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

dhe bashkëpunimit të përgjithshëm ndërshtetëror për parandalimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin adekuat të kryesve të veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit ndërkombëtar.

**U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi:
Ka ardhur koha për bashkëpunim të avancuar
ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit,
krimit të organizuar dhe pastrimit të parave**

Prishtinë, 9 tetor 2024 - Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur një takim të rëndësishëm me përfaqësuesit kryesorë të institucioneve në luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, duke përfshirë Administratën Tatimore të Kosovës, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Doganën e Kosovës, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Odën e Noterëve, Departamentin për Tatimin në Pronë në Ministrinë e Financave, Agjencinë Kadastrale dhe Agjencinë për Regjistrimin Civil, si dhe përfaqësues të tjerë institucionalë.



Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të mundësuar hetime efektive, duke u bazuar në të dhënat inteligjente dhe ndjekjen e lëvizjes së parave.

Më këtë rast, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, ka theksuar se bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë i nevojshëm, por duhet përmirësuar atë dhe është koha që të nxitet një

angazhim më i fortë dhe të mbahen përgjegjës aktorët që nuk tregojnë bashkëpunim të mjaftueshëm”.



Gjithashtu, z. Kelmendi, nënvizoi më tej se nuk mund të tolerohet më një situatë e tillë ku përgjegjësitë ndahen dhe qëllimet e përbashkëta mbeten pa u përmbushur dhe është koha që të gjitha institucionet të demonstrojnë një angazhim konkret dhe të pandërprerë për të arritur rezultate të prekshme. Ndër të tjera, ai ka theksuar se do të kërkojë llogaridhënie nga çdo institucion për përpjekjet e tyre, në mënyrë që të sigurohet që mungesa e përkushtimit nuk do të mbetet pa pasojë, sepse nevoja për përmirësim është urgjente dhe kërkon një nivel të ri të bashkëpunimit për të arritur qëllimet e përbashkëta në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Kjo nismë përforcon përkushtimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit për të avancuar luftën kundër korrupsionit dhe për të siguruar që institucionet përkatëse të bashkëpunojnë ngushtë për të ndjekur aktivitetet e paligjshme financiare dhe për të forcuar integritetin e institucioneve publike.

Kjo ngjarje mbështetet nga Projekti SAEK III, Zyra e UNDP-së në Kosovë, me ndihmën e Qeverisë Zvicerane përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë, dhe me ndihmën e Qeverisë Suedeze, përmes SIDA-së, në Kosovë.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit z. Besim Kelmendi, merr pjesë në lansimin e Rrjetit për Inteligjencë kundër Pastrimit të Parave në Kosovë

Prishtinë, 10 tetor 2024 – Në kuadër të avancimit të luftës kundër aktiviteteve të paligjshme financiare, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ishte pjesë e panelit gjatë lansimit të Rrjetit të Përbashkët për Inteligjencë kundër Pastrimit të Parave në Kosovë, të organizuar nga Njësia për Inteligjencë Financiare, ku morën pjesë edhe prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokurorë specialë dhe prokurorë të prokurorive themelore të Republikës së Kosovës, si dhe përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë dhe të institucioneve të vendit tonë.



Me këtë rast, z. Kelmendi, theksoi se ky rrjet do të jetë një edhe mekanizëm shtesë për punën e Prokurorit të Shtetit dhe një mundësi shumë e mirë për bashkëpunim në mes të institucioneve ligjzbatuese, si dhe sektorit privat, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave, para këto, të fituara nga kryerja e veprave penale shumë serioze, siç janë krimi i organizuar, terrorizmi dhe korrupsioni i nivelit të lartë, përmes të cilit dëmtohet rëndë buxheti i shtetit.



Më tutje, në fjalën e tij, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Kelmendi, deklaroi se vetë pjesëmarrja në këtë ngjarje e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokurorëve specialë dhe prokurorëve të prokurorive themelore të

Republikës së Kosovës, tregon gatishmërinë e Prokurorit të Shtetit për pjesëmarrje në Rrjetin për Inteligjencë kundër Pastrimit të Parave. “Jam këtu për të shprehur përkushtimin dhe angazhimin institucional dhe për të garantuar që të gjitha kapacitetet e Prokurorit të Shtetit janë në dispozicion për të mbështetur këtë rrjet të rëndësishëm, në mënyrë që suksesi kundër krimit të jetë sukses i përbashkët i të gjitha institucioneve ligj batuese dhe sektorit privat të bizneseve, sepse ky sukses është në interesin e qytetarëve të Kosovës dhe mundëson një bashkëpunim shumë më efektiv me partnerët tonë ndërkombëtar, si dhe lehtëson rrugën e Kosovës për integritet euroatlantike”, tha me këtë rast z.Kelmendi.

Po ashtu edhe pjesëmarrësit e tjerë të kësaj ngjarjeje, vlerësuan lart rolin dhe rëndësinë e lansimit të një rrjeti të tillë për luftimin e pastrimit të parave, krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit.

U.D. Kryeprokurori Kelmendi po merr pjesë në tryezën për Procedurën e Konfiskimit

Prishtinë, 16 Tetor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, po merr pjesë në tryezën e rrumbullakët lidhur me Procedurën e Konfiskimit që është duke u mbajtur në Durrës të Shqipërisë dhe e cila është organizuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik.



Në fokus të kësaj tryeze është efikasiteti në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin ku përfshihet edhe shitja e pasurisë së sekuestruar dhe asaj të konfiskuar.

Në tryezën për Procedurën e Konfiskimit po marrin pjesë prokurorë, gjyqtarë, përfaqësues nga Policia e Kosovës si dhe nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.



Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve vizitoi Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj

Gjilan dhe Ferizaj, 24 tetor 2024 - Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve - Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Bahri Hyseni së bashku me zyrtarët e deleguar nga institucionet ligjbatuese në këtë zyrë dhe përfaqësuesin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, vizituan sot Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe Prokurorinë Themelore në Ferizaj, ku u pritën nga kryeprokurorët dhe prokurorët e këtyre dy prokurorive.



Gjatë takimeve të mbajtura në këto prokurori, prokurori Hyseni i njoftoi të pranishmit për funksionalizimin e Zyrës për Rikthim të Aseteve, si dhe për Procedurat Standarde të Veprimit, duke kërkuar bashkëpunim nga prokurorët e këtyre prokurorive me këtë zyrë, me qëllim të këshillimit

dhe ndihmës për të gjithë prokurorët që kanë raste ku duhet të aplikohen procedurat për rikthimin e aseteve.



Gjatë këtyre takimeve është diskutuar dhe janë shkëmbyer mendime mbi përmirësimin e procedurave standarde të veprimit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, të cilat do të jenë ndihmesë për të gjithë prokurorët që kanë nevojë për ndihmën e Zyrës për Rikthim të Aseteve.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiçan z. Arben Kadriu, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, z. Shukri Jashari, së bashku me prokurorët e këtyre prokurorive, falënderuan pjesëmarrësit për vizitën e tyre, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me këto institucione për të arritur rezultate sa më të mira.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit kërkon nga kryeprokurorët rritje të efikasitetit në trajtimin e rasteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë dhe aplikimit të procedurave alternative

Prishtinë, 25 tetor 2024 – Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjin e rregullt me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit, përfaqësues të prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë.

Në këtë takim u diskutua për çështjet penale që ndërliken me bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë me ç'rast U.D. Kryeprokurori

Kelmendi ka kërkuar që këto raste të trajtohen me prioritet për të ngritur edhe imazhin e Prokurorit të Shtetit karshi partnerëve ndërkombëtarë.



Një çështje tjetër me rëndësi që u diskutua në këtë takim ishte edhe aplikimi i procedurave alternative, si procedura e efikase dhe produktive për zgjidhjen e rasteve penale nga ana e prokurorëve të shtetit, aplikimi i të cilave do të ndikojë në uljen e rasteve penale, zvogëlimin e kostos shtetit dhe palëve në procedurë, si dhe ekonomizimin e kohës.



Edhe për këtë çështje Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ka kërkuar nga kryeprokurorët e prokurorive aplikim të këtyre procedurave në çdo rast kur ka mundësi ligjore, duke i inkurajuar ata që të angazhohen maksimalisht në rritjen e efikasitetit në aplikimin e procedurave alternative.

U.D. Kryeprokurori i Shtetit ka marrë pjesë në Konferencën e Dytë Vjetore të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Prishtinë, 25 Tetor 2024 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, ka marrë pjesë në Konferencën e Dytë Vjetore të Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit me “Evoluimet në Drejtësinë Kushtetuese Bashkëkohore – Shembulli i Rajonit të Ballkanit”, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.



Në sesionet e Forumit të Gjykatave Kushtetuese u diskutuan tema profesionale si dhe u shkëmbyen praktikat më të mira në fushën e drejtësisë kushtetuese.

Pjesëmarrës në këtë konferencë të rëndësishme ndërkombëtare ishin udhëheqës dhe përfaqësues të institucioneve, kryetarë dhe gjyqtarë të Gjykatave Kushtetuese nga vende të ndryshme, profesor eminent dhe ekspertë të së drejtës kushtetuese. Gjithashtu, pjesëmarrës ishin edhe kryeprokurorë dhe kryetarë të gjykatave të Republikës së Kosovës.

U.D. Kryeprokurori Kelmendi po merre pjesë në punëtorinë “Administrimi i gjyqësorit, në mënyrë të veçantë përfshirja e komuniteteve në sistemin gjyqësor”

Prishtinë, 28 Tetor 2024 – Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, është duke marrë pjesë në punëtorinë “Administrimi i gjyqësorit, në mënyrë të veçantë përfshirja e komuniteteve në sistemin gjyqësor”, e cila po mbahet në Tiranë dhe është organizuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), dhe misioni i OSCE-së në Kosovë.

Duke folur për sfidat e integritetit të komuniteteve në sistemin e drejtësisë dhe zgjidhjet e mundshme



U.D. Kryeprokurori Kelmendi, gjatë sesioneve të diskutimit ka përcjellë praktikat më të mira të institucionit të Prokurorit të Shtetit që lidhen me reformën në drejtësi, sfidat dhe gatishmërinë për të avancuar qasjen në drejtësi për të gjithë qytetarët pa dallim, pavarësisht përkatësisë etnike.



Në këtë punëtori përveç U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, po marrin pjesë edhe Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, z. Fejzullah Rexhepi, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj, anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kryetarë të gjykatave dhe gjyqtarë si dhe përfaqësues të misionit të OSCE-së në Kosovë.

Prokurorë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës vizituan institucionin e Prokurorit të Shtetit

Prishtinë, 30 tetor 2024 – Sot në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit qëndroi për vizitë pune, prokurorja amerikane, znj. Angel Krull, e shoqëruar nga zyrtarë të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.



Delegacioni Amerikan u prit nga prokurorë nga Departamentet për të Mitur dhe prokurorët koordinatorë për rastet e trafikimit me qenie njerëzore, nga Prokuroritë Themelore dhe nga Prokuroria e Apelit.

Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të rëndësishme që ndërlidhën me luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, ku pati diskutime grupore për raste konkrete që prokurorët i kanë në punë.



Për të ndarë përvojën e saj profesionale në trajtimin e këtyre rasteve prokurorja amerikane Angel Krull para të pranishmëve bëri edhe një prezantim për trajtimin sa më profesional të rasteve që ndërlidhen me trafikimin me qenie njerëzore.